

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2021*

29.03.2021
Ora 12:43

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Për relatinin e kërkesës ankimore nr.7, me objekt "Kundërshtim i vendimit nr.172, dt.23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit, që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesmarrëse në zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë së datës 25 Prill 2021", subjekti ankues Koalicioni ABEOK".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj
- **Parti Politike:**
- **Koalicione:** ABEOK (z.Kostaq Papa, z.Selami Jenishehri)

Z. L. Braho: Përshëndetje! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.172, datë 23.03.2021 "Për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit, që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesmarrëse në zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë së datës 25 Prill 2021". Në mbështetje të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.3 të Komisionerit "Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga Buxheti i Shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve", ka vendosur të shpërndajë si paradhënie fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2021**

Shtetit partive politike pjesmarrëse në zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ndaj këtij vendimi në zbatim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur ankim koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), i cili në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr.7 në datë 25.03.2021. Në zbatim të nenit 12 të Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në datë 26.03.2021 është hedhur shorti i përcaktuar. Relatori i shqyrtimit të kësaj ankese ankimore, nga i cili u caktua relator anëtari Ledio Braho. Ju lutem prezantohuni kush jeni dhe në lidhje me legjitimitimin se në marrëveshjen që është paraqitur marrëveshjen e koalicionit, parashikohet që personi që përfaqëson koalicionin është avokati Shpëtim Kodhelaj. Me çfarë pashë ai është dhe personi që ka nënshkruar dhe ankimin që i është drejtuar KQZ-së atë që po gjykojmë sot. Në qoftë se na prezantohuni na thoni dhe në lidhje me legjitimin tuaj për këtë ankesë.

Z. K. Papa, deputet dhe bashkëdrejtues i Koalicionit ABEOK: Faleminderit, pavarësisht jemi të rastësishëm për momentin sot por unë jam një bashkëdrejtuesit e koalicionit po ashtu dhe zotëria. Jam Kostaq Papa deputet dhe bashkëdrejtues i koalicionit. Vërtet përfaqësues ligjor është avokati Shpëtim Kodhelaj, por për momentin ndodhet jashtë Tirane dhe duke qenë se ne u ndodhëm në KQZ mund të marrim pjesë dhe mund të diskutojmë në lidhje me problematikën dhe kërkesën që është bërë ndaj Komisionit të Ankimeve dhe Sqarimeve. Besoj se këtë të drejtë na e jep ligji përderisa jemi bashkëdrejtues të koalicionit, jemi pak më lart se avokati, faleminderit. Në fakt unë isha te minoranca e diskutimit të këtij problemi kur u diskutua në koalicionit tonë. Duke qenë se nuk kam ndonjë interesim për lekët do të thoja nëse vërtet na takojnë do

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2021*

të dëshiroja që këto lekë të shkonin të bëhej një infermieri në një nga fshatrat që ka zënë tërmeti. Do të bënim humanizëm, por doja që të shikonim këtë problematikë në kuadër të ligjit, në kuadër të precedentit, në kuadër sesi është vepruar me partitë e tjera që janë të përafërta. Duhet të keni parasysh që ligji i ndan lekët në bazë të mandateve dhe ne jemi 4 mandate.


Z. L. Braho: Zoti Papa kjo është çështje e themelit, është seancë e verifikimit të kushteve paraprake, pra në qoftë se plotësohen kriteret. Për legjitimin meqenëse jemi në kushtet e dy kryetarëve dhe dy partive përbërëse të koalicionit. Po ju, jeni?!

Z. S. Jenishehri, drejtues i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve: Jam Kryetar i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve. Bëj pjesë tek ky koalicion, kam ardhur të ndjek zhvillimin e kësaj ankese. Përfaqësues për koalicionin tonë është zoti Papa.

Z. L. Braho: Për seancën e sotme, dakord me praninë tuaj, por në rastin që nëse me vendimmarrje do të pranohet për shqyrtim kërkesa dhe do të lihet data për shqyrtimin e themelit, ose duhet të vijë avokati Shpëtim Kodhelaj që është caktuar që në fillim nga ju si personi i autorizuar, ose duhet të merrni ju një autorizim dhe nga dy subjektet e tjera që të jeni ju për seancën e radhës gjithmonë nëse do të pranohet kërkesa.

Z. K. Papa, deputet dhe bashkëdrejtues i Koalicionit ABEOK: Ishte dhe një nga anëtarët e tjerë i paraqitur zoti Gjuzi, por duke qenë se thjesht ne erdhëm për

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve
Dt.29.03.2021**

prezencë për të ndjekur procedurën e ndoqëm, në vend se duke e quajtur të mjaftueshme prezencën e dy personave.

Z. L. Braho: Ka ndonjë pretendim nga ju në lidhje me anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve në gjendjen në kushtet e konfliktit të interesave?


Z. K. Papa, deputet dhe bashkëdrejtues i Koalicionit ABEOK: Jo.

Z. L. Braho: Seanca e sotme siç e relatova dhe në fillim është seancë e verifikimit paraprak dhe zhvillohet në zbatim të neneve 17 dhe 18 të Rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të KAS” dhe më konkretisht verifikohen elementët e parashikuar nga neni 130 të Kodit Zgjedhor që janë: “Kompetenca e KAS-it për shqyrtim dhe ankim”, “Legjitimimi i ankuesit” dhe “Respektimi i afateve ligjore për ankimin”. Zoti Merkaj në lidhje me çështjen, përsa u përket këtyre elementeve?

Z. Y. Merkaj: Atëherë vendimi që ankimohet është dhënë në datën 23.03.2021. Kërkesa ankimore kundër këtij vendimi është paraqitur në datën 25.03.2021, brenda afatit 3 ditor të përcaktuar nga rregullorja. Nga kompetencë e KQZ-së KAS-i është kompetente për të shqyrtuar këtë çështje. Respektimi i afateve është respektuar kështu që legjitimimi i ankuesit ngelet për t’u diskutuar.

Z. L. Braho: Faleminderit, atëherë Komisioni i Ankimimeve dhe Sankcioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar. Neni 17, pika 3, shkronja “a” e neni 18 të vendimit “Për mënyrën e funksionimit” KAS vendos:

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2021*

1. Pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.7 datë 25.03.2021, paraqitur nga Kolacioni ABEOK. Shqyrtimi do të bëhet në datën 30 Mars 2021 në orën 12:30.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
Sëancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr.12

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*

